

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve P. K., V. K. dhe L. K. nga Prishtina të cilët i përfaqëson av.Xh. K., nga Prishtina, kundër të paditurave Ministria e Infrastrukturës, me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson N. A., sipas autorizimit dhe Kompania e Sigurimeve “C. S.” në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, përkitazi me revizionin e paditësve dhe të paditurës së parë, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.3990/2013 datë 05.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 4.10.2016, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

I. Refuzohen si të pathemeltë revizioni i së paditurës së parë paraqitur kundër pjesës së I-rë të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.3990/2013 dt.5.04.2016 dhe revizioni i paditësve paraqitur kundër pjesës së I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë që ka të bëjë me pjesën e I,II,III dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë C.nr.2960/10 dt.11.06.2013.

II. Pjesa e II e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë dhe pjesa e IV dhe VI e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, mbeten të pashqyrtuara.

A r s y e t i m i

Me pjesën e parë e I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, me pjesën e II, detyrohet e paditura e parë, që paditësit P. K., në emër të kompensimit të dëmit për 50% të përgjegjësisë për aksidentin e dt.19.12.2010,t'i paguajë dëmin jo material për dhimbje fizike shumë prej 3000-euro,për frikë 2000€. Me pjesën e III, detyrohen të paditurat, që në mënyrë solidare, në emër të kompensimit të dëmit për dhimbje fizike t'i paguajnë paditëses V. K., shumë prej 5000€ dhe për frikë shumë prej 3000€, kurse, paditësit L. K., për dhimbje fizike shumë prej 4000€ dhe për frikë shumë prej 2500€.Me pjesën e IV, detyrohet e paditura e parë që paditëses V. K., për 50% të përgjegjësisë, t'i paguajë në emër të dëmit material në automjet shumë prej 3336-€.Me pjesën e V, detyrohen të paditurat që paditësve t'u paguajnë edhe kumatën ligjore për pjesën e aprovuar të kërkesëpadiës duke filluar nga dt.11.06.2013 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 2184€ në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënim përmbartimi ligjor. Me pjesën e VI, ka refuzuar pjesën e kërkesëpadiës për paditësin e parë,për dhimbje fizike në shumë prej 7000€, për frikë 8000€, për paditësen e dytë, për dhimbje fizike në shumë prej 5000€, për frikë 7000€ dhe për paditësin e tretë, për dhimbje fizike në shumë prej 6000 €dhe për frikë 7500€ si të pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës,Ac.nr.3990/2013 dt.5.04.2016(me pjesën e I të dispozitivit), është pranuar pjesërisht ankesa e së paditurës së parë dhe të dytë, ndërsa, aktgjykimi i shkallës së parë është ndryshuar në pjesët që kanë të bëjë me kompensimin e dëmit jo material të paditësve (dhimbje fizike dhe frikë), ashtu që ka vendosur: Për paditësin e parë, për dhimbje fizike, gjykohet shuma prej 500€, për frikë 500€, për paditësen e dytë, për dhimbje fizike shuma prej 1000€, po aq edhe për frikën dhe për paditësin e tretë, për dhimbje fizike 1000-euro,po aq edhe për frikën, ndërsa, në pjesën tjetër, ankesat e të paditurave dhe ankesën e paditësve i ka refuzuar si të pabazuara.(pjesa II dhe III e dispozitivit).

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht vetëm pjesës së parë të dispozitivit të tij, që ka të bëjë me kompensimin e dëmit jo material paditësve për dhimbjet fizike dhe për frikën, në afat ligjor, ka paraqitur revizion e paditura e parë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet revizioni, të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së dytë, vetëm për sa i përket pjesës së I të dispozitivit, ashtu që të refuzohet kërkesëpadia e paditësve si e pabazuar.

Poashtu, kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, pjesës së I dhe III të dispozitivit të tij, përkatësisht pjesës së I, II, III dhe V të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të LPK dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësve ashtu siq ka vendosur gjykata e shkallës së parë, me ndryshim që kamata të caktohet në shkallë prej 3,5% nga dita e ushtrimit të padisë apo t'a prish dhe t'a kthejë lëndën në rigjykim.

Përgjigje në revizionin e së paditurës së parë ka paraqitur pala paditëse, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizionet e paditësve dhe i së paditurës së parë janë të pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me dt.19.12.2010, rreth orës 16, në rrugën magjistrale në H. i E., ka ndodhur aksidenti i komunikacionit si pasojë e rrëshqitjes nga rruga, humbje e kontrollit dhe dalje nga rruga e një veture të cilën e ngiste paditësi i parë duke u përplasur në objekte jashtë rrugës, me ç'rast janë lënduar tre persona dhe është shkaktuar dëm material. Deri ke aksidenti ka ardhur për shkak të mos mirëmbajtjes së rrugës në kohën e sezonit të domërit nga subjekti i autorizuar dhe nga mos përshtatja e shpejtësisë së lëvizjes kushteve të papërshtatshme të rrugës. Konstatim ky i nxjerrë nga ekspertiza e komunikacionit të ekspertit Yll Koshi, sipas të cilit, deri te aksidenti nuk do të vinte sikur rruga të ishte mirëmbajtur duke mënjanuar borën dhe eliminuar akullin me hedhjen e kripës dhe rërës, masa këto të parapara për mirëmbajtjen e rrugës në sezonin dimëror, (që nuk ishin ndërmarrë) gjithashtu, duke pasur parasysh edhe kushtet e rrugës që ishin të papërshtatshme edhe përkundër shpejtësisë së lejuar të lëvizjes që kishte shoferi i veturës (paditësi i parë), në këtë rast ai është dashtë që të zvogëloj shpejtësinë e lëvizjes për t'a përshtatur me kushtet që dominonin në rrugë. Se paditësi i parë si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të lehta trupore (ekspertizat mjekësore), ndrydhje e regjionit humeroskapular të majtë, ndrydhje e regjionit të kofshës së majtë, gërvishje në regjionin orbital të majtë dhe regjionin e hundës në anën e djathtë. Ka përjetuar dhimbje fizike me intensitet të rënd 24 orë, të mesëm 10 ditë, të ultë 2 javë, ka pasur frikë primare që ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 3 orë, mesatar 2 javë, të ultë tre muaj, që është manifestuar me çrregullime

të ritmit të gjumit, ulje të vullnetit për punë, ankth, shqetësim, ankesa të shumta somatike. Paditësja e dytë ka pasur ndrydhje të regjionit të kokës, ndrydhje në regjionin e qafës. Lëndime që kualifikohen si lëndime të lehta trupore. Dhimbje të intensitetit të rënd 24 orë, të intensitetit të mesëm 2 javë, të ulët 2 javë. Frikë primare disa sekonda si pasojë e frikës nga përfundimi fatal, sekondare që nënkupton ankthin, preokupimin me procedurat mjekësore, frikën rreth pasojave eventuale, që kanë zgjatur rreth dy javë sa ka qenë e imobilizuar qafa, frikë të intensitetit të ulët 3 muaj, që është manifestuar me çrregullime të ritmit të gjumit, ankth frikë, shqetësim, ankesa të shumta somatike, rënie e performancës dhe vullnetit në punë. Paditësi i tretë, po ashtu ka marrë lëndime të lehta trupore, ndrydhje dhe gërvishtje në shuplakën e dorës së djathtë. Dhimbje fizike me intensitet të rënd 6 orë, të mesëm 7 ditë, të ultë 7 javë. Ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë 3 orë, të intensitetit mesatar 2 javë, të intensitetit të ulët që është manifestuar me çrregullime të ritmit të gjumit, tmerre të natës, ankth, frikë, shqetësim dhe ankesa të shumta somatike.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, duke pasur parasysh përgjegjësinë e ndarë 50% me 50% midis ndërgjyqësve, si dhe në bazë të dispozitave të nenit 154, nenit 178, nenit 200, nenit 206 të LMD-ës, pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve, ka detyruar të paditurat që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, të paguajnë shumat për katse, ndërsa, ka refuzuar kërkesë padin e paditësve mbi shumat e gjykuara dhe ka vendosur si në pjesën I, II, III, IV, V dhe VI të dispozitivit të aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore përkitazi me kompensimin e dëmit jo material të paditësve, për dhimbjet fizike dhe frikën e përjetuar, e ka miratuar pjesërisht ankesën e të paditurave, ka ndryshuar pjesët e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, që kanë të bëjë vetëm me llojet e sipërcekura të dëmit jomateria l dhe ka vendosur si në dispozitivin nën I të aktgjykimit të sajë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e së drejtës materiale, kur ka pranuar pjesërisht ankesën e së paditurës së parë dhe të dytë dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë, vetëm përkitazi me kompensimin e dëmit jo material të paditësve për dhimbjet fizike dhe frikën, duke gjykuar për lartësinë e shumave të sipërpërmendura dhe aktgjykimi i goditur nuk përmban as shkelje të karakterit thelbësor të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Për sa i përket shumave të gjykuara nga Gjykata e shkallës së dytë (pjesa e ndryshuar) përkitazi me llojet e sipër përmendura të dëmit jo material, drejtë është aplikuar dispozita e nenit 200 të LMD-ës, duke patur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve mjekësor, lëndimet e pësuar, natyrën ,peshën, intensitetin e dhimbjeve, frikës së paditësve (moshën e paditësit të tretë) etj. Vlerësimi i shpërblimit për dëmin jo material (si një satisfacion që nuk ka qëllim lukrativ-fitimprurës), përfaqëson zbatimin e së drejtës materiale. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, edhe të frikës si lloj i mëvetësishëm i dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD-së, duhet të kujdeset për rëndësinë e së mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por, edhe për çështjen që të mos favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimin shoqëror, prandaj, duke pasur parasysh këto kritere të parapara me dispozitën e lartëcekur, shumat e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë, përkitazi me llojet e sipërcekura të dëmit jo material, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate janë reale, në përputhje me kriteret e parapara ligjore dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

Prandaj, nga sa u sipër theksua, kjo Gjykatë, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i revizionit të së paditurës së parë lidhur me mungesën e legjitimitetit real pasiv të sajë, nga fakti sepse vërtetë sikundër rezulton nga shkresat e lëndës dhe konstatimi i gjykatës së shkallës së parë, edhe e paditura e parë është përgjegjëse për kompensimin e dëmit përkatës paditësve, në mënyrë solidare me të paditurën e dytë, sipas bazës së përgjegjësisë së ndarë (neni 192 i LMD-së), nga se, e paditura e parë është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror, ajo në fakt kishte kontraktuar përgjegjësinë për dëmin me një subjekt tjetër, por jo në mënyrë shprehimore-eksplicite (shih nenin 12.2 të Kushteve të përgjithshme nga Kontrata e lidhur midis së paditurës së parë dhe kontraktuesit "RSM Dreal Ndërtim, Asfaltim Rruga "Prishtinë në shkresat e lëndës) edhe përgjegjësinë për mbulimin e dëmeve që shkaktohen për shkak të mosmirëmbajtjes së rrugëve në aksidentet e komunikacionit gjatë sezonit të dimërit, siç është rasti konkret.

Poashtu, është i pabazuar edhe pretendimi i revizionit të paditësve, lidhur me kamatën, kjo Gjykatë vlerëson se drejtë është zbatuar e drejta materiale edhe në këtë rast, sepse kamata rrjedh nga dita e marrjes së aktgjykimit ashtu siq kanë vendosur gjykatat e instancës më të ulët, sikundër që janë të pabazuara edhe pretendimet tjera rreth shkeljes së dispozitave të procedurës

kontestimore dhe gjykimit të shumave të ulta për llojet e sipër përmendura të dëmeve jo materiale.

Pjesa e II e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së dytë dhe pjesa e IV dhe VI e dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë, mbeten të pashqyrtuara ngase nuk janë goditur me revizion.

Nga sa u theksua më lartë, e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.221/2016 datë 4.10. 2016

Kryetari kolegjit

-----  
Mr.Sc.Muhamet Rexha

